

R I S H P A L L E T N J O F T I M P Ë R A P L I K I M

PËR POZICIONIN E DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË INSTITUTIT TË STATISTIKAVE (INSTAT)

Mbështetur në fjalinë e fundit, të pikës 10, të vendimit nr.669, datë 7.11.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e procedurave, të kriterëve të vlerësimit dhe afateve të njoftimit për përzgjedhjen e kandidaturave për t’u emëruar në pozicionin “Drejtor i Përgjithshëm i Institutit të Statistikave””, Këshilli i Ministrave rishpall njoftimin për të aplikuar për pozicionin e drejtorit të Përgjithshëm të Institutit të Statistikave (INSTAT).

Aplikimet e dorëzuara brenda datës 21 tetor 2019 nuk duhen ridërguar. Ato do t’i nënshtrohen verifikimit të përmbushjes së kriterëve ligjore dhe vlerësimit përkatës, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përmbajtja e këtij njoftimi për aplikim bazohet në pikat 2, 3 e 5, të nenit 16, të ligjit nr.17/2018, “Për statistikatat zyrtare”, si dhe në vendimin nr.669, datë 7.11.2018, të Këshillit të Ministrave.

Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT-it kujdeset për të siguruar pavarësinë profesionale të institucioneve brenda sistemit kombëtar statistikor dhe drejton strategjinë e zhvillimit të tij. Ai drejton veprimtarinë koordinuese të aktiviteteve statistikore të prodhuesve brenda sistemit kombëtar statistikor, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT-it emërohet nga Kuvendi, me propozimin e Këshillit të Ministrave, pas një procedure të hapur dhe publike përzgjedhëse.

○ Aplikanti duhet të plotësojë këto kriterë:

- a) të jetë shtetas shqiptar;
- b) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- ç) ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore e largimit nga institucionet e administratës publike;
- d) të ketë gradën shkencore “Doktor” në shkencat ekonomike ose ekzakte;
- dh) të ketë përvojë pune për një periudhë jo më pak se 10 (dhjetë) vjet;

e) të zotërojë gjuhën angleze.

○ **Dokumentet që duhet të dorëzohen janë:**

- Kërkesë për aplikim;
- Kopje të letërnjoftimit;
- *Curriculum Vitae* në gjuhën shqipe;
- Dokumente të diplomimit;
- Dokumente që provojnë vjetërsinë në profesion dhe marrjen e gradës shkencore “Doktor” në shkencat ekonomike ose ekzakte;
- Certifikata e dokumente që provojnë përvojë pune dhe kualifikime në fushën e prodhimit dhe/ose të përdorimit të statistikave;
- Dokument që provon zotërimin e gjuhës angleze dhe gjuhëve të tjera të huaja
(nëse ka);
- Kopje të prezantimeve të punimeve në konferenca/simpoziume shkencore;
- Formular të vetëdeklarimit (të plotësuar e të firmosur), në zbatim të ligjit nr.138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, të ndryshuar;
- Formular të aplikimit (të plotësuar e të firmosur) për informim, për zyrtarët përpara emërimit/zgjedhjes në poste të larta, në zbatim të ligjit nr.45/2015, “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”;
- Vetëdeklarim se nuk është larguar nga institucionet e administratës publike me masë disiplinore.

(Deklarimi i rremë sjell përjashtimin nga çdo procedurë e mëtejshme e konkurrimit dhe përgjegjësi penale, sipas legjislacionit në fuqi).

○ **Afati i dorëzimit të aplikimit, deri më 16 nëntor 2019.**

- **Adresa:** *Kryeministria
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr.1, 1000
Tiranë, Shqipëri*

*Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm
Tel.: 00355 4 22 77 401*

- *Aplikantët njoftohen individualisht dhe nëpërmjet web-faqes zyrtare të Kryeministrit për verifikimin e plotësisht të kriterëve të kërkuara, për procesin e ankimimit, si dhe për informacione të tjera të nevojshme.*
- **Aplikantët që plotësojnë kriteret u nënshtrohen vlerësimit të jetëshkrimit dhe një interviste të strukturuar me gojë.**
- **Data e shpalljes së listës së kandidatëve që do të kualifikohen për fazën e intervistës: brenda datës 27 nëntor 2019.**
- **Data dhe vendi i zhvillimit të intervistës: brenda datës 12 dhjetor 2019, Kryeministria.**
- **Fushat e njohurive, për të cilat do të intervistohen kandidatët, janë:**
 - i.** njohuri në fushën e statistikave, përmbajtjen e programit pesëvjeçar të statistikave zyrtare;
 - ii.** njohuri për Kushtetutën, Kodin e Procedurave Administrative dhe për legjislacionin e funksionimin e administratës publike;
 - iii.** njohuri për legjislacionin mbi të cilin mbështetet funksionimi i sistemit kombëtar statistikor.
- Kandidatët i paraqesin komisionit të posaçëm të vlerësimit të kandidaturave, në ditën e intervistës së strukturuar me gojë (data e së cilës njoftohet individualisht për secilin), një prezantim të shkurtër në format *Power Point* lidhur me:
 - filozofinë drejtuese;
 - strategjitë e risitë që mund të sjellë gjatë kryerjes së funksionit drejtues.

Inkurajojmë të gjithë të interesuarit për aplikim.